



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

Nr. 10 (S) 2025 i Regjistrimit Themeltar

Nr. 133 i Vendimit

V E N D I M

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 03.06.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (S) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SADETIN SULA, përfaqësuar nga avokat Ilir Murati, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1586, datë 02.10.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.04.2016, në fshatin Melgushë, Shkodër, në mjediset e brendshme të një njësie biznesi të kërkuesit është gjetur e vdekur bashkëshortja e tij, shtetasja S.S., vdekje e cila në vijim ka rezultuar se është shkaktuar nga asfiksia mekanike, konkretisht nga shtrëngimi i qafës me duar dhe mjete të tjera rrethanore ndihmëse. Për këtë ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*Prokuroria për Krime të Rënda*), në datën 26.04.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. 83, për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal (KP), ndaj kërkuesit (bashkëshorti i viktimës). Gjatë hetimeve paraprake është realizuar një ekspertim biologjik ADN-je, përmes të cilit ekspertët kanë ndërtuar profilin gjenetik të mbetjeve humane të marra nga thonjtë e dorës së djathtë të viktimës dhe nga ku ka rezultuar se kontribuesi i seksit femër në këtë profil gjenetik ishte viktimja, kurse kontribuesi mashkull mbetej i paidentifikuar. Akti në fjalë përjashtonte si kontribues kërkuesin.

2. Në datën 11.05.2017, në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria për Krime të Rënda ka paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i KP-së, në dëm të viktimës S.S.

3. Në datën 17.01.2018, ndërsa çështja penale në ngarkim të kërkuesit ndodhej në gjykim, po për këtë ngjarje Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. 9, për të njëjtën vepër penale, por në rrethanën rënduese të bashkëpunimit, të parashikuar nga nenet 79/c dhe 25 të KP-së, duke shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e shtetasit F.K., i dyshuar si bashkautor. Në seancën gjyqësore të datës 02.02.2018, për shkak të këtyre rrethanave të dala rishtazi, mbështetur në nenin 373 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), prokurori i ka komunikuar të pandehurit (kërkuesit), rrethanën e re të bashkëpunimit, duke e riformuluar akuzën në ngarkim të tij, sipas së cilës krimi është ideuar dhe urdhëruar nga ai, kurse ekzekutori material i krimit (i mbytjes së viktimës S.S.) është i bashkëpandehuri F.K., në një procedim të lidhur.

4. Në seancën gjyqësore të datës 15.02.2018 gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për bashkimin e çështjes së tij me procedimin penal në ngarkim të të hetuarit F.K., duke vlerësuar, në kuptim të përmbajtjes së nenit 92 të KPP-së, se këto çështje nuk janë në të njëjtën gjendje dhe shkallë, pasi njëra është në fazë hetimi paraprak dhe tjetra është objekt gjykimi përpara kësaj gjykatë.

5. Në datën 26.03.2018 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*Gjykata për Krime të Rënda*), e cila ishte në fazën e diskutimeve përfundimtare, ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendimin nr. 883, datë 10.05.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka zhvilluar disa seanca gjyqësore, ka shpallur moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës për Krime të Rënda. Kjo e fundit, në përgjigje të kërkesës së mbrojtjes së kërkuesit për mosvazhdimin e gjykimit deri në shqyrtimin e çështjes së kompetencës nga Gjykata e Lartë, ka vlerësuar se ka kompetencën lëndore për gjykimin e çështjes, pasi bazuar në nenin 285, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 35/2017, deri në krijimin Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka në kompetencë lëndore veprat penale sipas nenit 75/a të KPP-së, të pandryshuar. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vijuar shqyrtimin e çështjes në fazën ku kishte mbetur me arsyetimin se, bazuar në nenin 438, pika 4, të KPP-së dhe në respektim të vendimit njëses nr. 13, datë 04.04.2018 të Gjykatës së Lartë (i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme), si dhe e ndodhur përpara një vendimmarrjeje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin asaj të çështjes penale, kishte kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes penale.

6. Në përfundim të gjykimit, Gjykata për Krime të Rënda, me vendimin nr. 68, datë 11.06.2018, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të parashikuar nga neni 79/c i KP-së, dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Sipas asaj gjykate, në gjykim është provuar kryerja e veprës penale dhe se autor i saj, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, është edhe kërkuesi, i cili ka vepruar në dëm të bashkëshortes së tij S.S., në bashkëpunim me të bashkëpandehurin në një procedim të lidhur, shtetasin F.K. Sipas asaj gjykate, në nivelin që janë provat, nisur nga rrethanat e faktit, është më se e mjaftueshme për të arritur në përfundimin logjik se të dy të pandehurit në marrëveshje të mëparshme janë marrë vesh dhe më pas kanë bashkëvepruar me qëllim realizimin e qëllimit kriminal, vrasjen e viktimës. Në vlerësimin e asaj gjykate, i pandehuri (kërkuesi) ka kryer një vepër penale me rrezikshmëri të madhe dhe po ashtu edhe vetë ai paraqet rrezikshmëri të lartë, duke iu referuar rrethanave të faktit dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 56, datë 26.07.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se është provuar fakti kriminal në përbërësit e tij, veprimet, pasoja dhe lidhja shkakësore ndërmjet tyre, si dhe fajësia përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për kryerjen edhe nga kërkuesi të veprës penale

të parashikuar nga neni 79/c i KP-së. Edhe për masën e dënimit ajo gjykatë ka vlerësuar njësoj si ajo e shkallës së parë, se i pandehuri (kërkuesi) e ka kryer krimin në rrethanat rënduese dhe pa praninë e ndonjë rrethane lehtësuese, duke vlerësuar se dënimi duhet të jetë me burgim të përjetshëm. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi nëpërmjet mbrojtësve të tij.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2024-1586, datë 02.10.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, në vendimet e gjykatave më të ulëta nuk konstatohet mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk konstatohet mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i gjykatës së apelit të bjerë në kundërshtim me praktikën e asaj gjykate.

9. Në datën 10.04.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata për Krime të Rënda nuk ka respektuar dispozitat që lidhen me numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për formimin e kolegjeve, për shkak se në trupin gjykues kanë marrë pjesë 5 gjyqtarë, ndërkohë që sipas ligjit nr. 35/2017, që prej datës 01.08.2017, vepra penale e kryer nga kërkuesi gjykohet me 3 gjyqtarë. Po kështu, trupi gjykues që e ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Lartë ka dhënë më parë një vendim në një proces civil me palë kërkuesin, i cili rezulton në disfavor të tij. Nga ana tjetër, kompetente për shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vendimmarrja e saj nuk e bënte Gjykatën për Krime të Rënda automatikisht kompetente, por në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural penal duhej të pritej vendimmarrja e Gjykatës së Lartë si i vetmi organ “*ex lege*” për të zgjidhur konfliktin e kompetencës së ngritur nga gjykatat më të ulëta. Edhe Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh pretendimet e ngritura në rekurs për kompetencën lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda.

- 10.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi data dhe ora e gjykimit në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë nuk janë shpallur në këndin e njoftimeve ose në faqen zyrtare të saj, ndërkohë që kërkuesi gjendej në burg në kohën e gjykimit të çështjes. Po kështu, edhe mbrojtësi i kërkuesit nuk është njoftuar përmes postës elektronike (e-mail).
- 10.3. *Së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Penal e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, pa i njoftuar palët për të paraqitur parashtrime me shkrim. Duke qenë se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.09.2019 dhe janë tejkaluar të gjitha afatet e gjykimit, njoftimi i palëve ishte i detyrueshëm. Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë pa praninë e kërkuesit dhe avokatit të zgjedhur nga ai ose të ndonjë mbrojtësi tjetër.
- 10.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat kanë rënduar pozitën e kërkuesit. Argumentet e tij nuk janë dëgjuar njëjloj si argumentet e organit të akuzës, duke e vendosur atë në një pozitë të disfavorshme në raport me palën tjetër. Gjykatat nuk kanë respektuar as rregullat procedurale për marrjen dhe vlerësimin e provave.
- 10.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit, në vendimin e saj, çështjet ligjore të ngritura në ankim nga kërkuesi nuk i ka trajtuar dhe arsyetuar, por është kufizuar në arsyetimin e përdorur nga gjykata e shkallës së parë, duke mos kryer funksionin e saj të një gjykate që kontrollon ligjshmërinë e vendimit të shkallës së parë. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në kundërshtim me nenin 425, pika 1, të KPP-së, nuk ka marrë në shqyrtim dhe as nuk ka trajtuar kundërshtimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 15.02.2018 të gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesës për bashkimin e procedimit, i cili është ankimuar bashkë me vendimin përfundimtar.
- 10.6. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi në kuptim të nenit 380 të KPP-së, në dosjen gjyqësore nuk ndodhet asnjë akt, i cili të sjellë njoftim (neni 149 i KPP-së) me fuqi provuese dhe i konfirmuar me prova të tjera (neni 152 i KPP-së), që të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka organizuar ose nxitur vrasjen e bashkëshortes së tij S.S. Çështja në ngarkim të kërkuesit duhet të pushohet, pasi nuk provohet se ai ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- 10.7. *Së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi kampioni biologjik për kryerjen e aktit të ekspertimit është marrë në kundërshtim me nenin 201/a të KPP-së, i cili kërkon pëlqimin e personit të cilit i merret dhe jo në fshehtësi ose në rrugë operative, siç është proceduar në rastin konkret.
- 10.8. *Së drejtës për gjykim të drejtë*, sepse gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, duke miratuar qëndrimin e prokurorit për mënyrën e të proceduarit për të pandehurin tjetër F.K., pasi duke qenë se kishte dy procedime me dy persona, të cilët akuzohen për të njëjtën vepër penale, të kryer në bashkëpunim, ishte e domosdoshme bashkimi i procedimeve penale. Organi i akuzës ka argumentuar “fajësinë” e të bashkëpandehurit në rolin e ekzekutorit, ndërkohë që provat në ngarkim të tij nuk u shqyrtuan përpara asaj gjykate, duke krijuar një situatë absurde. E vetmja referencë do të ishte neni 374 i KPP-së, i cili detyron prokurorin të tërheqë aktet dhe të vazhdojë hetimet me dy të bashkëpandehurit. Duke qenë se ky veprim nuk u krye nga organi i akuzës, duhej të ishte konstatuar kryesisht nga gjykata.
- 10.9. *Parimit të individualizimit të dënimit dhe të proporcionalitetit*, pasi gjykatat kanë zbatuar gabim kriteret e neneve 47-50 të KP-së për caktimin e dënimit ndaj kërkuesit. Asnjëra nga gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk kanë argumentuar arsyet se përse nuk kanë caktuar një dënim me 20 vjet ose 30 vjet burgim, por burgim i përjetshëm, duke mos vlerësuar rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, marzhin e dënimit në raport me pasojën, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Gjukata e Lartë, edhe pse i është kërkuar interpretim për individualizimin e dënimit, ka argumentuar vetëm faktin se gjykatat kanë zbatuar drejt ligjin, ndërkohë që duhet të interpretonte drejt kërkesat e KP-së për caktimin e dënimit, duke unifikuar praktikën gjyqësore me standardet e gjithëpranuara ligjore. Në rastin e kërkuesit nuk është caktuar një dënim i drejtë.
- 10.10. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjukata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ato të mbajtura më parë në çështje të ngjashme (vendimi nr. 3, datë 02.11.2015 i Kolegjeve të Bashkuara për individualizimin e dënimit). Ajo nuk ka mbajtur parasysh vendimet e Gjykatës për aspektin harmonik të dispozitave penale, duke vërejtur paqartësi dhe spontanitet në qëllimin e përzgjedhjes së mjetit të ashpërsimit të dënimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuari duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimin nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Kolegji vëren se kërkuari legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, rezulton se kërkuari, në këndvështrim të *së drejtës për gjykim të drejtë*, ka pretenduar, se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, pasi organi i akuzës ka argumentuar “fajësinë” e të bashkëpandehurit në rolin e ekzekutorit, ndërkohë që provat në ngarkim të tij nuk u shqyrtuan përpara gjykatës së shkallës së parë, duke krijuar një situatë absurde. Kolegji vlerëson se për sa kohë ky argument ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të një personi tjetër gjatë procesit gjyqësor penal, kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ka provuar interesin e tij të drejtpërdrejtë në këtë drejtim.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

14. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi objekt kërkesë i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mban datën 02.10.2024, i cili, sipas komunikimit të dërguar nga ajo gjykatë përmes postës elektronike, është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 13.12.2024, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 10.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi, edhe pse në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar vetëm vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në përmbajtje të tij ka ngritur pretendime edhe për vendimet gjyqësore të gjykatave më të ulëta. Për sa i përket thelbit të pretendimeve, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit, së drejtës për t’u mbrojtur dhe asaj për t’u dëgjuar, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor edhe në këndvështrim të parimit të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për mos t’u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të gjykimit të drejtë, parimit të individualizimit të dënimit dhe të proporcionalitetit, si dhe parimit të sigurisë juridike.

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* si në drejtim të (i) *kompetencës së gjykatës* që ka gjykuar çështjen e tij, ashtu edhe për sa i përket (ii) *përbërjes së trupit gjykues*. Në jurisprudencën e saj për të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata ka theksuar se termi “*gjykatë*” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj nga ligji (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 47, datë 11.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj ka të bëjë edhe përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete, për rrjedhojë pretendimet që ngrihen për shkeljen e rregullave ligjore për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të një trupi gjykues janë të tilla që kërkojnë shqyrtim nga ajo (*shih vendimin nr.14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa i përket pretendimit për *kompetencën e gjykatës*, sipas kërkuessit, kompetente për shqyrtimin e çështjes ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërkohë që vendimmarrja e saj për shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës për Krime të Rënda nuk e bënte këtë të fundit kompetente, por duhej të pritej vendimmarrja e Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës së ngritur nga gjykatat më të ulëta. Kolegji vëren se çështja penale në ngarkim të kërkuessit është regjistruar në Gjykatën për Krime të Rënda në datën 16.05.2017. Sipas vendimit njëses nr. 13, datë 04.04.2018 të Gjykatës së Lartë, çështjet e paraqitura në Gjykatën për Krime të Rënda përpara datës 01.08.2017 do të vazhdonin të gjykoreshin në këtë gjykatë edhe pas kësaj date, deri në momentin e krijimit të Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Me vendimin e datës 26.03.2018, pra përpara vendimit njëses, Gjykata për Krime të Rënda ka shpallur moskompetencën lëndore, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në vijim çështja i është dërguar sërish asaj gjykate me vendimin e datës 10.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga ana tjetër, kjo e fundit, më herët, në kuadër të caktimit të masës së sigurimit ndaj kërkuessit, pas dërgimit asaj të çështjes për kompetencë lëndore, me vendimin e datës 19.04.2018, ka ngritur çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore përpara Gjykatës së Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2018-293, datë 11.09.2018, ka përcaktuar si kompetente Gjykatën për Krime të Rënda. Edhe pse kjo e fundit ka vijuar me gjykimin e çështjes, ndërsa mosmarrëveshja e kompetencës ishte për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, duke mos pranuar edhe kërkesën e mbrojtjes së kërkuessit për të mos vijuar gjykimin në pritje të atij vendimi, ajo gjykatë e ka bazuar qëndrimin e saj në ligjin nr. 35/2017, që parashikon se deri në krijimin e Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ajo gjykatë vijon të ketë në kompetencë lëndore veprat penale të parashikuara në nenin 75/a të KPP-së dhe vendimin njëses të Gjykatës së Lartë, e cila, duke interpretuar ligjin procedural penal, ka arritur në të njëjtin përfundim. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuessit në drejtim të kompetencës së gjykatës që ka gjykuar çështjen e tij është haptazi i pabazuar.

18. Për sa i përket pretendimit për përbërjen e trupit gjykues, kërkuessi ka argumentuar se çështja e tij duhej të ishte shqyrtuar me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë dhe jo nga 5 gjyqtarë. Kolegji vëren se pas regjistrimit të çështjes së kërkuessit në Gjykatën për Krime të Rënda në datën 16.05.2017, ajo është shortuar në datën 23.05.2017, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të ligjit nr. 9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, duke i kaluar për shqyrtim trupit gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të datës 10.05.2018, që e ka konsideruar veten jokompetente për gjykimin e saj, çështja është kthyer në Gjykatën për Krime

të Rënda. Në këtë kohë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 35/2017, i cili përcaktonte se Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjykon me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë (*neni 8, pika 4*) dhe deri në krijimin e kësaj gjykate çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykoreshin, përkatësisht, nga Gjykata për Krime të Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore (*neni 285, pika 1*), ndërsa përbërja e trupave gjykues rregullohej tashmë sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera (*neni 285, pika 7*).

19. Me urdhrin nr. 97, datë 11.05.2018 të kryetarit të Gjykatës për Krime të Rënda, çështja i ka kaluar për shqyrtim të njëjtit trup gjykues prej 5 gjyqtarësh të caktuar sipas shortit të datës 23.05.2017, pasi kjo gjykatë ka disponuar për këtë çështje me vendim jopërfundimtar, duke ia dërguar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër . Ky urdhër është bazuar në nenin 25 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 98/2016*) dhe në nenin 5 të vendimit nr. 283/1/a, datë 24.12.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, që përcaktonte se çështjet e caktuara me short dhe për të cilat ishte disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, përjashtoheshin nga shorti dhe i kalonin automatikisht të njëjtit gjyqtar. Në këto kushte, çështja penale në ngarkim të kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata për Krime të Rënda me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuesit është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka vlerësuar të pabazuar, duke arsyetuar se edhe për numrin e gjyqtarëve që kanë krijuar trupin gjykues zbatohen parashikimet e mëparshme ligjore deri në formimin e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe se gjykimi me 5 gjyqtarë është një garanci më shumë për të gjykuarin (*shih paragrafin 25 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se shqyrtimi nga Gjykata për Krime të Rënda i çështjes së kërkuesit nga një trup gjykues i përbërë nga 5 gjyqtarë nuk përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi gjyqtari natyral për të zgjidhur çështjen konkrete është ai që identifikohet pas hedhjes së shortit dhe çdo procedurë e ndryshme jo vetëm do të binte ndesh me parashikimet e nenit 25 të ligjit nr. 98/2016 dhe nenit 342 të KPP-së, sipas të cilit gjen zbatim parimi i gjykimit të çështjes në mënyrë të pandërprerë nga e njëjta gjykatë, por do të ishte njëkohësisht në kundërshtim me garancitë që ofron neni 42, pika 2, i Kushtetutës. Për më tepër, përbërja e trupit gjykues me 5 gjyqtarë përbën garanci më të lartë në drejtim të cilësisë së vendimmarrjes, për rrjedhojë pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

21. Kërkuesi ka pretenduar po në drejtim të këtij parimi se trupi gjykues që ka gjykuar çështjen e tij në Gjykatën e Lartë ka dhënë më parë një vendim në një proces civil ku ai ka qenë palë, i cili rezulton në disfavor të tij. Kolegji vëren se edhe pse pretendimi ka të bëjë, në thelb, me *parimin e paanshmërisë në gjykim*, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë dhe të provojë në këndvështrimin kushtetues lidhjen mes dy proceseve gjyqësore, ose gjyqtarët që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen e tij penale në Gjykatën e Lartë të ketë bërë më parë vlerësime për fajësinë e kërkuesit gjatë shqyrtimit të çështjes tjetër civile, pra që të ketë paragjykuar fajësinë e tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

22. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat kanë rënduar pozitën e tij dhe se argumentet e tij nuk janë dëgjuar njëllor si argumentet e organit të akuzës, duke e vendosur atë në një pozitë të disfavorshme me palën tjetër. Gjykata është shprehur se veçanërisht në procesin penal, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe lidhur ngushtë me këtë, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë, në vetvete, elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se, në kundërshtim nga sa pretendohet nga kërkuesi, gjykatat e faktit i kanë krijuar atij të njëjtën mundësi, si dhe akuzës për të paraqitur çështjen, sikundër edhe për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tij. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykatat nuk është bërë vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga akuza, por, përkundrazi, kërkuesit i është dhënë mundësia të dëgjohet për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore. Me kërkesën e mbrojtjes në gjykim janë dëgjuar bisedat e regjistruara në aparatën telefonik të viktimës dhe të vajzës së saj, është marrë si provë një akt ekspertimi audioteknik për bisedat e regjistruara dhe po me kërkesë të mbrojtjes ekspertët që kanë përpiluar aktin e ekspertimit teknik kanë dëshmuar në seancë gjyqësore edhe procedurën teknike të ekstraktimit, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të mbrojtjes për mundësinë e manipulimit të provës dokumentare. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se marrja e provave i është nënshtruar debatit real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes dhe procedurat për mënyrën sesi janë siguruar ato rezultojnë në përputhje me ligjin procedural, ndaj edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

24. Lidhur me pretendimin për *cenimin e parimit të individualizimit të dënimit dhe proporcionalitetit*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë zbatuar gabim kriteret e neneve 47-50 të KP-së për caktimin e dënimit ndaj tij. Ai ka pretenduar se asnjëra nga gjykatat, përfshirë Gjykatën e Lartë, nuk kanë argumentuar arsyet se përse nuk kanë caktuar një dënim me burg 20 vjet ose 30 vjet, por burgim të përjetshëm, duke mos vlerësuar rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, marzhin e dënimit në raport me pasojën, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuetit, për nga përmbajtja e tij, është, në thelb, me natyrë ligjore, pasi lidhet me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme për sa i përket caktimit të dënimit për veprën penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “c”, i KP-së, për të cilën ligji parashikon si dënim jo më pak se 20 vjet burgim ose burgim të përjetshëm. Për më tepër, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në vendimet e tyre për masën e dënimit të caktuar se kanë mbajtur parasysh kërkesat e nenit 47 të KP-së, duke e caktuar në përputhje me kufijtë që parashikon dispozita konkrete, si dhe duke mbajtur parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuetit është haptazi i papabazuar, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Kërkuesi ka pretenduar edhe *cenimin e parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur më parë në çështje të ngjashme për individualizimin e dënimit dhe nuk ka mbajtur parasysh vendimet e Gjykatës për aspektin harmonik të dispozitave penale, duke vërejtur paqartësi dhe spontanitet në qëllimin e përzgjedhjes së mjetit të ashpërsimit të dënimit. Kolegji vëren se në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet sipas kontekstit të rrethanave të secilës prej tyre. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë që çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këtë standard, Kolegji vlerëson se fakti se Kolegji Penal mund të ketë vendosur ndryshe në raste të ngjashme nuk përbën *per se* argument për vënien në dyshim të procesit gjyqësor nga pikëpamja kushtetuese. Për më tepër, kërkuesi jo vetëm që nuk ka argumentuar pretendimin e tij në drejtim të qëndrimit të ndryshëm të pretenduar se është mbajtur nga Gjykata e Lartë, por ai e ka lidhur edhe këtë pretendim, në thelb, me mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat për caktimin e masës së dënimit ndaj tij. Për

rrjedhë, kërkuesi nuk ka arritur të provojë në këndvështrimin kushtetues këtë pretendim, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

26. Kërkuesi për sa i takon *standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me gjykimin e drejtë*, ka pretenduar se edhe gjykata e shkallës së parë ka proceduar në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, duke miratuar qëndrimin e prokurorit për mënyrën e të proceduarit për të pandehurin tjetër F.K., pasi duke qenë se kishte dy procedime me dy persona, të cilët sipas akuzës kanë konsumuar të njëjtën vepër penale për të cilën akuzohen në bashkëpunim midis tyre, ka qenë e domosdoshme bashkimi i procedimit penal. Sipas tij, neni 374 i KPP-së detyron prokurorin të tërheqë aktet nga gjykata dhe të vazhdojë hetimet me dy të bashkëpandehurit, por në kushtet që kjo nuk u bë nga organi i akuzës duhej të ishte konstatuar kryesisht nga gjykata.

27. Për këtë pretendim, Kolegji vëren se gjatë gjyimit në shkallë të parë mbrojtësi i kërkuesit, në ushtrim të së drejtës për të paraqitur kërkesa procedurale, ka paraqitur kërkesën për bashkimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit tjetër F.K. me atë në shqyrtim, në ngarkim të kërkuesit, me pretendimin se ata akuzohen për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim dhe për të parandaluar situatën që dikush të marrë pafajësi dhe dikush tjetër të dënohet. Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata e shkallës së parë, pasi e ka marrë në shqyrtim, ka vlerësuar se është e pabazuar, sepse nuk ndodhet përpara kërkesave të parashikuara nga neni 92, pika 1, i KPP-së, sipas të cilit bashkimi i çështjeve që qëndrojnë në të njëjtën gjendje dhe shkallë përpara së njëjtës gjykatë mund të vendoset, kur nuk dëmtohet shpejtësia e zgjidhjes së tyre. Sipas asaj gjykate, në rrethanat kur procedimi penal në ngarkim të të pandehurit F.K. ishte në fazën e hetimeve paraprake dhe ende nuk kishte kaluar për gjykim, ndërsa çështja e kërkuesit ishte në gjykim përpara saj, për rrjedhojë çështjet nuk ishin në të njëjtën gjendje dhe shkallë që kërkon dispozita procedurale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vetëm rrëzimi i kësaj kërkesë nga gjykata e shkallës së parë nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të kundërshtuar, për sa kohë që kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për pamundësinë e zbatimit të nenit 92 të KPP-së në rastin konkret, për shkak të gjendjes së ndryshme në të cilën ndodhen çështjet. Ky arsyetim i gjykatës nuk duket të jetë haptazi i pabazuar ose arbitrar, pra që të vërë në dyshim atë vendimmarrje në këndvështrim kushtetues, në kuptimin që ta bëjë gjykimin të padrejtë. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

28. Kërkuesi në lidhje me *mënyrën e marrjes së provave*, ka pretenduar gjithashtu se akti i ekspertimit biologjik i ADN-së nr. 141, datë 08.01.2018, i cili përmendet në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit F.K., jo vetëm nuk i është vënë në

dispozicion, por është marrë në kundërshtim me urdhërimet e nenit 201/a të KPP-së, që kërkon pëlqimin e personit të cilit i merret kampioni biologjik dhe nuk lejon marrjen e tij në fshehtësi ose në rrugë operative, siç është proceduar në rastin konkret, duke e bërë atë të papërdorshëm. Sipas kërkuarit, ky pretendim nuk është shqyrtuar dhe analizuar nga gjykatat e zakonshme.

29. Kolegji vëren, fillimisht, se ky pretendim i kërkuarit ka të bëjë me marrjen e materialit biologjik të shtetasit F.K., pra të bashkëpandehurit në një gjykim tjetër dhe jo të vet kërkuarit. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuarit i referohet aktit të ekspertimit biologjik të ADN-së nr. 141, datë 08.01.2018, që, sipas tij, përmendet në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit F.K., që ka të bëjë me marrjen në rrugë operative të një shisheje uji të përdorur nga shtetasi F.K., nga e cila është tentuar të merret material biologjik për të ndërtuar materialin gjenetik të atij shtetasi. Ndërkohë, referuar vendimeve gjyqësore që kanë gjykuar dhe dënuar kërkuarin, në përcaktimin e fajësisë së tij ato janë bazuar edhe në aktin “Procesverbal për marrjen e kampionit për kryerjen e ekspertimit biologjik të ADN” të datës 22.01.2018, për marrjen e dy kampioneve të mostrave të pështymës nga goja e shtetasit F.K. dhe aktin e ekspertimit biologjik krahasues të ADN-së nr. 1226, datë 30.01.2018, për rezultatin e analizës së kampionit të marrë atij shtetasi. Për rrjedhojë, ky akt i pretenduar si i marrë në kundërshtim me ligjin nuk rezulton të jetë përdorur si provë në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuarit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

30. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuarit, për *cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t’u dëgjuar*, bazuar në natyrën e argumenteve të parashtruara dhe thelbin e tyre, Kolegji vlerëson t’i shqyrtojë në këndvështrim të së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t’u dëgjuar. Ndërsa pretendimet e tjera të kërkuarit në këndvështrim të parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, parimit të gjykimit të drejtë, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe të standardit të arsytimit, Kolegji, bazuar edhe në mënyrën sesi kërkuari i ka paraqitur pretendimet, çmon që t’i analizojë në vijim në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t’u dëgjuar

31. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Penal e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit pa i njoftuar palët për të paraqitur parashtrimet me shkrim. Sipas tij, duke qenë se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.09.2019 dhe janë tejkaluar të gjitha afatet e gjykimit, njoftimi i palëve ishte i detyrueshëm. Sipas kërkuarit, gjykimi i çështjes në

Gjykatën e Lartë është bërë pa praninë e kërkuarit dhe të avokatit të zgjedhur, ose të ndonjë mbrojtësi tjetër. Kërkuari ka pretenduar se edhe data edhe ora e gjykimit në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë nuk janë shpallur as në këndin e njoftimeve ose faqen zyrtare të saj, ndërkohë që kërkuari gjendej në burg në kohën e gjykimit të çështjes. Po kështu, mbrojtësi i kërkuarit nuk është njoftuar përmes postës elektronike (*e-mail*).

32. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare. Ajo u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 27.01.2017; nr. 34, datë 25.07.2011; nr. 34, datë 03.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në procesin penal mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, prandaj për respektimin e tyre gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuari është pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me anë të rekursit, në të cilin ka parashtruar shkaqet për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuari ka zgjedhur të mbrohet me një avokat të zgjedhur prej tij, i cili në datën 12.07.2024 ka paraqitur përpara asaj gjykate edhe një shtesë rekursi. Sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, si dhe në bazë të verifikimeve të kryera në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se fillimisht, përmes shpalljes së datës 10.06.2024, ajo gjykatë ka njoftuar shqyrtimin e çështjes së kërkuarit në dhomën e këshillimit në datën 16.07.2024, si dhe përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Penal. Në datën 16.07.2024 trupi gjykues ka vendosur të shtyjë seancën për t'u zhvilluar në një datë tjetër. Në vijim, me shpalljen e datës 31.07.2024, Gjykata e Lartë ka njoftuar shqyrtimin e çështjes së kërkuarit në datën 24.09.2024. Po sipas akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se në datën 31.07.2024, përmes postës elektronike *e-mail*, sekretaria gjyqësore ka njoftuar në adresën elektronike të përfaqësuesit ligjor të kërkuarit se çështja e tij do të shqyrtohej në dhomën e këshillimit në datën 24.09.2024. Në vijim, me shpalljen e datës 24.09.2024 është njoftuar

shqyrtimi i çështjes së kërkuarit në datën 02.10.2024, por nuk rezulton që kjo datë t'i jetë njoftuar atij ose përfaqësuesit të tij përmes postës elektronike.

34. Gjykata është shprehur se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes të të drejtave kushtetuese dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në proces kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt ligjor nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuarin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Kolegji, bazuar për sa më sipër, vëren se kërkuari ka pasur dijeni për datën 16.07.2024 të planifikuar për shqyrtimin e rekursit të tij, për datën e shtyrjes, si dhe në vijim ai është njoftuar se shqyrtimi do të bëhej në një datë tjetër. Edhe pse kërkuari ose mbrojtësi i tij nuk janë njoftuar personalisht përmes postës elektronike (*e-mail*) për shqyrtimin e rekursit në datën 02.10.2024, Gjykata e Lartë rezulton të këtë njoftuar rregullisht për këtë seancë në mjediset e saj dhe në faqen zyrtare. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në kushtet kur kërkuari i është garantuar ushtrimi i së drejtës së rekursit, si dhe rezulton se ka paraqitur edhe akte shtesë në Gjykatën e Lartë, përmes të cilave ka parashtruar pretendimet e tij në kundërshtim të vendimeve të gjykatave të faktit, vetëm mungesa e njoftimit personalisht për datën e shtyrë të shqyrtimit të çështjes së tij nuk është e tillë që ta bëjë të parregullt procesin në kuptimin kushtetues. Gjithashtu, vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, në funksion të verifikimit të kriterëve të pranueshmërisë së tij për shqyrtim, nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për sa kohë që Kolegji Penal ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale, të cilat gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

36. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

37. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka trajtuar çështjet ligjore të ngritura në ankim, nuk i ka trajtuar dhe arsyetuar ato, por është kufizuar në arsyetimin e përdorur nga gjykata e shkallës së parë duke mos e kryer funksionin e saj të një gjykate të shkallës së dytë që kontrollon ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kërkuari ka pretenduar se edhe çështja në ngarkim të tij duhet të pushohet, pasi nuk provohet fajësia për sa kohë që ajo nuk është argumentuar dhe arsyetuar nga gjykatat mbi bazën e akteve me fuqi provuese

dhe të konfirmuara me prova të tjera që të provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka organizuar ose nxitur vrasjen e bashkëshortes së tij S.S. Sipas tij, si vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe ai i apelit për krime të rënda kanë interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar nenet 4, 149, 152, 380, 383/1/9, 390/1, 425/1, 426/a/5, 427/1/2 të KPP-së, si dhe nenet 79/c dhe 25 të KP-së.

38. Në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit, Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm te faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se arsyetimi i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se një arsyetim i tillë është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitat përkatëse procedurale që janë kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Nga ana tjetër, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventalisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Kolegji vëren se kërkuesi është proceduar penalisht si autor i dyshuar për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79/c dhe 25 të KP-së. Kërkuesi është mbrojtur nga avokat i zgjedhur gjatë gjithë

procesit penal. Çështja e tij është gjykuar me procedurë të zakonshme, veçmas asaj në ngarkim të shtetasit F.K. Kërkuesi ka mbajtur qëndrim mohues ndaj akuzës. Në gjykim janë marrë provat e kërkuara nga organi i akuzës, të tilla, si, procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe të kufomës, akti i ekspertimit mjeko-ligjor i viktimës, akti i ekspertimit toksikologjikoligjor i viktimës, akti i ekspertimit biologjik krahasues i ADN-së së viktimës, procesverbalet e sekuestrimit të dokumenteve dhe akti i ekspertimit grafik shkrimi, procesverbalet e këqyrjes së aparateve të telefonave të viktimës dhe të kërkuesit/bashkëshortit të saj, dy akte ekspertimi teknik telefonik të viktimës, procesverbali i transkriptimit të bisedave të regjistruara në aparatin telefonik të viktimës, tabulatet telefonike të viktimës dhe të kërkuesit (bashkëshortit të saj), prova këto të grumbulluara në kuadër të procedimit penal. Po kështu, me kërkesë të organit të akuzës, në gjykim janë marrë edhe prova me dëshmitarë, si dhe i bashkëpandehuri F.K. Për provat e paraqitura nga organi i akuzës, kërkuesi dhe mbrojtësit e tij kanë pasur mundësi t'i debatonin dhe t'i kundërshtonin ato. Në këtë kuadër, me kërkesën e mbrojtjes, fillimisht, në gjykim janë dëgjuar bisedat e regjistruara në aparatin telefonik të viktimës dhe të vajzës së saj, në vijim, është marrë si provë një akt ekspertimi audio-teknik në lidhje me bisedat e regjistruara si dhe ekspertët dëshmuar në seancë gjyqësore dhe procedurën teknike të ekstraktimit dhe u dhanë përgjigje pretendimeve të mbrojtjes, duke hedhur poshtë çdo dyshim për mundësinë e manipulimit të provës dokumentare.

41. Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i KP-së, duke arsyetuar se në nivelin që janë provat e administruara është provuar, përtej çdo dyshim të arsyeshëm, si kryerja e veprës penale, ashtu edhe se autor i saj është kërkuesi dhe se ai ka vepruar në bashkëpunim me shtetasin F.K. Edhe në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit për kërkuesin ajo gjykatë ka mbajtur parasysh kërkesat e nenit 47 të KP-së, kufijtë e dënimit që parashikon dispozita penale (burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm), si dhe rrezikshmërinë e veprës penale, të vet të pandehurit, shkallën e fajit të tyre në kryerjen e veprës penale, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese.

42. Gjykata e apelit, e vënë në lëvizje me ankimin e kërkuesit, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ka gjetur të provuar faktin kriminal në përbërësit veprime, pasojë dhe lidhje shkakësore ndërmjet tyre, fajësinë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesi. Ajo gjykatë në arritjen e këtij përfundimi është bazuar në aktet e administruara në procesin gjyqësor, mes të cilave aktet e këqyrjes; aktet e ekspertimit teknik të ekstraktimit të regjistrimeve në telefonin e shtetas S.S. (vajza e kërkuesit dhe e viktimës), nga të cilat përftohen të dhëna me rëndësi për

marrëdhëniet bashkëshortore mes kërkuesit dhe viktimës; prova dokument e sekuestruar në çantën e viktimës (letra me shkrim dore) që i është nënshtruar ekspertimit grafik të shkrimit, që jep të dhëna për gjendjen shpirtërore të viktimës; njoftimet e përfutuara nga skedarët audio të ekstraktuara nga memoria e telefonit celular të viktimës, të nënshtruara ekspertimit teknik, e pranuar si provë e re gjatë gjykimit në shkallë të parë, të cilat japin të dhëna për implikimin e kërkuesit në bashkëpunim me shtetasin F.K. në kryerjen e veprës penale dhe provojnë të kundërtën e asaj që ka pretenduar mbrojtja; akti i ekspertimit biologjik i ADN-së nr. 4619, datë 24.05.2016, i materialit biologjik të marrë nga thonjtë e viktimës, përmes të cilit është ndërtuar profili gjenetik human i plotë; akti i ekspertimit biologjik krahasues i ADN-së nr. 1226, datë 30.01.2018, përmes të cilit është provuar në mënyrë kategorike se kontribuesi mashkull është i bashkëpandehuri F.K.; dëshmitë e dëshmitarëve, ashtu dhe veprimet dhe sjelljet e kërkuesit ditën e ngjarjes me qëllimin për të krijuar një alibi mbrojtjeje, indicie këto që janë çmuar, në kuptim të përmbajtjes së nenit 152, pika 2, të KPP-së, në tërësinë e tyre dhe së bashku me provat e tjera, shkencore e dokumentare të shqyrtuara në këtë proces, dhe që, sipas asaj gjykate, provojnë përtej çdo dyshimi faktin se kërkuesi është organizatori dhe nxitësi i krimit, kurse i bashkëpandehuri në procedim të lidhur F.K., ekzekutori material i tij. Gjykata e apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi ka marrë në shqyrtim edhe pretendimet e kërkuesit të ngritura në ankim në drejtim të vendimmarrjes së shkallës së parë, i ka gjetur ato të pabazuara.

43. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, duke i vlerësuar të pabazuara shkaqet e ngritura në të. Sipas Kolegjit Penal, vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit material e procedural penal dhe në rekurs kërkuesi i referohet pjesërisht vlerësimit të provave, duke bërë analizën e tyre, ashtu siç janë parashtruar këto pretendime edhe gjatë gjykimeve në të dyja shkallët, pretendim, i cili del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Më tej, Kolegji Penal për pretendimet e parashtruara në ankim, për të cilat është pretenduar në rekurs se nuk janë marrë për shqyrtim nga gjykata e apelit, ka vlerësuar se arsyetimi i asaj gjykate ka qenë i qartë kur ka pranuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ka bërë pjesë të arsyetimit të vendimmarrjes së saj, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit të ngritura gjatë gjykimit, të cilat janë përsëritur përsëri në ankim, por duke mos evidentuar asnjë fakt të ri. Edhe pretendimi për zbatim të gabuar të ligjit material penal Kolegji Penal e ka vlerësuar të pabazuar, duke arsyetuar se gjykatat e faktit kanë analizuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 79/c i KP-së në raport me veprimet dhe mosveprimet e të gjykuarit (kërkuesi) dhe bashkëpunëtorit të tij. Sipas atij kolegji, konstatohet

me të drejtë se gjykatat e faktit nuk kanë pranuar të marrin nga mbrojtja prova, për të cilat nuk është argumentuar rëndësia e tyre dhe ndikimi në vërtetimin ose jo të akuzës, ndërkohë që nga tërësia e provave të shqyrtuara është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi në bashkëpunim me të pandehurin tjetër F.K. kanë kryer në bashkëpunim veprën penale, për të cilën akuzohen. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, vendimet e gjykatave të faktit janë të argumentuara, si në parashtrimin e procedurës së gjykimit, parashtrimin e faktit penal, analizën e provave, dhënien përgjigje pretendimeve të kërkuesit, si dhe analizën e elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 79/c i KP-së, si dhe rrethanës cilësuese të parashikuar nga neni 25 i KP-së, dhe se nuk konstatohen shkaqe nga ato që mund të bëjnë të cenueshëm vendimin e kundërshtuar (*shih paragrafët 24-44 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

44. Kolegji, në kuptim të standardeve të mësipërme dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të dhëna në çështjen e kërkuesit, vlerëson se ato tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranura dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar në zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprave penale, duke analizuar për këtë qëllim në vendimet e tyre përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një mori provash, përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm. Gjykatat kanë vlerësuar provat dhe pretendimet e palëve, përfshirë edhe ato të kërkuesit, dhe në analizë të tyre kanë zbatuar në vijim ligjin penal ndaj tij. Provat mbi të cilat gjykatat kanë mbështetur vendimet e tyre janë pikërisht ato që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe në formën e kërkuar nga ligji. Gjykatat e faktit kanë arsyetuar edhe për çdo veprim procedural të kryer, sikundër edhe për çdo kërkesë procedurale të kërkuesit. Nisur nga kjo, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit që kanë deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesin kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre, ndërkohë që interpretimi i ligjit prej tyre, i shprehur përmes arsyetimit të vendimit, nuk duket të jetë i paarsyeshëm ose eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Edhe për sa i përket vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, Kolegji vlerëson se ai tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe në pjesën arsyetuese argumentet ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsyetimit të kufizuar për to, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë argumenton se, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se

rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

45. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet e çështjes dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme dhe, si të tilla, nuk përfshihen në juridiksionin e kësaj Gjykate.

46. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 03.06.2025

A N Ë T A R E

A N Ë T A R

K R Y E S U E S E

/Marjana Semini/(d.v.)

/Ilir Toska/(d.v.)

/Fiona Papajorgji/(d.v.)

Vërtetohet njësia me origjinalin

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Eugen PAPANDILE